



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike 2006-2012





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike 2006-2012



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit: Dhjetor 2013

© : *Agjencia e Statistikave të Kosovës*

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së
në internet: <http://esk.rks-gov.net>

Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), respektivisht departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare publikon të dhënat e Bruto Produktit Vendor (BPV) sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale dhe konstante (me çmime të vitit paraprak) për vitet 2006-2012. Metodologjia për kalkulimin e BPV është sipas koncepteve dhe përkufizimeve të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA95).

ASK do të vazhdojë zhvillimin e Llogarive Kombëtare në pajtim me rekomandimet ndërkombëtare dhe do të publikojë të dhëna kualitative dhe me kohë. Falënderojmë Ministrinë e Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, Ministrinë e Administratës Publike (sektori i OJQ-ve), ndërmarrjet, zyret rajonale dhe agjensionet tjera për bashkëpunim.

Shënim: Të dhënat për vitet prej 2008 – 2011 do të rishikohen në vitin 2014 për shkak të:

- Ndryshimeve metodologjike (nga ESA 95 dhe SNA 93 në ESA 2010 dhe SNA 2008);
- Përdorimit të të dhënave të reja nga regjistrimi i Popullsisë në vitin 2011 si dhe
- Për shkak të korigjimeve në burimin e të dhënave (BQK)

Ky publikim është përgatitur nga:
Ilir T. Berisha – Drejtor i departamentit,
Xhevrie Fetahu – Shefe e divizionit,
Ylli Shala – zyrtar i lartë,
Ilir Mazrekaj – zyrtar i lartë,
Emine Bajrami – zyrtare e lartë,
Florije Krapë – zyrtare e lartë,
Nysret Sylejmani – zyrtar i lartë
Besim Mehmeti – zyrtar i lartë

Komentet dhe sugjerimet tuaja janë të mirëseardhura.

Prishtinë, dhjetor 2013

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së,
z. Isa Krasniqi

Përmbajtja

I. Hyrje	3
Tabela 1: Bruto produkti vendor sipas aktiviteve ekonomike me çmime aktuale 2006-2012	5
Tabela 2: Struktura e Bruto produkti vendor sipas aktiviteve ekonomike 2006-2012	6
Tabela 3: Bruto produkti vendor sipas aktiviteve ekonomike me çmime konstante 2006-2012	7
Tabela 4: Bruto produkti vendor me qasjen e shpenzimeve 2004-2012.....	8

I. Hyrje

Llogaritë kombëtare paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe tërësore për të gjitha transaksionet që kanë ndodhur brenda një periudhe të caktuar, dhe në këtë mënyrë ato paraqesin një pamje të përgjithshme të ekonomisë kosovare. Ato ofrojnë një përshkrim sistematik statistikor dhe të qëndrueshëm të ekonomisë në përgjithësi dhe raportin reciprok ndërmjet sektorëve të ndryshëm ekonomik dhe ekonomisë në përgjithësi si dhe pjesës jo-rezidente. Vetë llogaritë kombëtare në një mënyrë më të përmbledhur paraqesin një masë të madhe të informacioneve të hollësishme, të organizuara në bazë të parimeve dhe perceptimeve ekonomike lidhur me funksionimin e ekonomisë.

II. Bruto Produkti Vendor (BPV)

Treguesi më i rëndësishëm ekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtare është Bruto Produkti Vendor (BPV), i cili paraqet performancën e ekonomisë së një shteti në një periudhë të caktuar.

Ekzistojnë tri qasje për matjen e BPV: qasja e prodhimit, shpenzimeve dhe e të ardhurave.

Bruto produkti vendor sipas qasjes së prodhimit, është i barabartë me shumën e gjithsej të bruto vlerës së shtuar për të gjitha veprimtaritë ekonomike, plus tatimet në produkte të zvogëluara për subvencionet në produkte.

Vlen të ceket se BPV-ja bën vlerësimin e prodhimit nga njësitë rezidente, pavarësisht nga lokacioni i veprimtarisë prodhuese.

Qasja e prodhimit

$$BPV = BVSH + TP - SP$$

Prej nga:

BPV = Bruto produkti vendor (me çmimet e tregut)

BVSH = Bruto vlera e shtuar (me çmimet bazë)

TP = Tatimet në produkte

SP = Subvencionet në produkte

III. Vlerësimi

1. Outputi

Outputi vlerësohet brenda një periudhe të caktuar kohore si vlerë e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara nga ndërmarrjet rezidente. Outputi mund t'iu shpërndahet njësive tjera ose mund të shfrytëzohet për konsum vetanak apo për formimin e bruto kapitalit fiks vetanak.

2. Konsumi i ndërmjetëm

Konsumi i ndërmjetëm është vlera e përgjithshme e mjeteve të përdorura, konsumuara apo të transformuara gjatë procesit të prodhimit. Konsumi i ndërmjetëm përfshinë mallrat dhe shërbimet e prodhuara vetëm nga njësia tjetër ekonomike (prodhimi vetanak nuk përshihet). Ngjashëm me outputin, ai vlerësohet brenda një periudhe të caktuar kohore.

3. Vlera e shtuar

Vlera e shtuar është një koncept thelbësor ekonomik i prodhimit që i referohet vlerës së prodhuar nga njësia e angazhuar në veprimtari prodhuese. Bruto vlera e shtuar definohet si output i përgjithshëm minus konsumi i ndërmjetëm.

Vlera e shtuar llogaritet veçmas për secilën veprimtari rezidente në ekonomi. Ajo ofron një vlerësim detaj të aktiviteteve prodhuese.

IV. Burimet e të dhënave

a) Burimet statistikore të të dhënave:

- Rezultatet e anketave të kryera dhe publikuara nga ASK, si: anketa strukturore e ndërmarrjeve, anketa e buxhetit të ekonomive shtëpiake (ABESH), anketa e fuqisë punëtore (AFP), anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore (AESHB) dhe publikimet e ASK;
- Të dhënat e tregtisë së jashtme : importi dhe eksporti i mallrave;
- Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK), Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP), të cilët shërbejnë si deflator.

b) Burimet administrative:

- Ministria e Financave (MF), sa i përket të dhënave të buxhetit dhe të thesarit;
- Banka Qendrore e Kosovës (BQK), sa i përket të dhënave të Bilancit të pagesave (BoP), bankave, kompanive të sigurimeve dhe njësive tjera financiare;
- Ministria e Administratës Publike sa i përket të dhënave të Organizatave jo qeveritare (OJQ).

Tabela 1: Bruto produkti vendor sipas aktiviteve ekonomike me çmime aktuale 2006-2012

(në 000)

Nr.	Aktivitetet ekonomike	Bruto Vlera e Shtuar (BVSH)						
		2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
1	Bujqësia, gjuetia , pylltaria dhe peshkimi	372,375	479,603	526,334	532,720	630,342	705,535	615,379
2	Industria nxjerrëse	20,372	17,989	31,383	29,916	48,763	81,120	112,693
3	Industria përpunuese	310,950	289,177	418,839	465,852	411,899	399,431	589,216
4	Furnizimi me energji elektrike, me gaz dhe me ujë	100,339	137,671	152,128	170,971	179,889	190,280	146,263
5	Ndërtimtaria	284,183	343,541	326,606	336,233	371,939	398,162	337,174
6	Tregetia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave dhe i artikujve për përdorim personal dhe shtëpiak	343,790	423,839	553,972	574,487	615,124	723,308	770,584
7	Hotelet dhe restorantet	24,509	25,644	40,390	30,794	61,149	37,102	40,459
8	Transporti, magazinimi dhe komunikacioni	145,534	122,667	232,650	149,062	157,942	207,775	225,026
9	Ndërmjetesimi financiar	96,058	149,669	164,050	190,583	194,603	231,246	187,413
10	Afarizmi me pasuri të patundshme, dhënia me qira dhe shërbime të afarizmit	408,715	426,346	385,759	382,111	356,853	267,082	255,785
11	Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi social i detyrueshëm (a+b)	553,704	540,229	549,442	542,376	563,661	636,541	688,261
a	<i>Qeveria e Kosovës</i>	223,404	225,870	247,242	281,576	337,061	409,531	471,181
b	<i>Donatorët</i>	330,300	314,359	302,200	260,800	226,600	227,010	217,080
12	Vepimtari të tjera shoqërore sociale, të shërbimeve dhe personale	84,156	77,551	105,780	127,805	104,649	165,572	166,879
13	Gjithsej aktivitetet (1 deri 12)	2,744,685	3,033,924	3,487,334	3,532,911	3,696,813	4,043,155	4,135,132
14	Tatimet në produkte	501,222	577,089	641,890	686,650	795,523.7	949,830.6	973,591.6
15	FISIM	75,447	91,866	117,611	111,055	120,515.0	136,704.1	110,480.0
16	Subvencionet ne produkte	(50,049)	(58,379)	(71,289)	(100,719)	(80,677)	(80,159)	(81,844)
	Bruto Produkti Vendor (13+14-15+16)	3,120,411	3,460,768	3,940,324	4,007,788	4,291,144	4,776,122	4,916,400

Tabela 2: Struktura e Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike 2006-2012

Nr.	Aktivitetet ekonomike	Pjesëmarrja e BPV sipas aktiviteteve						
		2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
1	Bujqësia, gjuetia , pylltaria dhe peshkimi	11.5	13.3	12.7	12.6	14.0	14.1	12.0
2	Industria nxjerrëse	0.6	0.5	0.8	0.7	1.1	1.6	2.2
3	Industria përpunuese	9.6	8.0	10.1	11.0	9.2	8.0	11.5
4	Furnizimi me energji elektrike, me gaz dhe me ujë	3.1	3.8	3.7	4.1	4.0	3.8	2.9
5	Ndërtimtaria	8.8	9.5	7.9	8.0	8.3	8.0	6.6
6	Tregetia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave dhe i	10.6	11.7	13.4	13.6	13.7	14.5	15.1
7	Hotelet dhe restorantet	0.8	0.7	1.0	0.7	1.4	0.7	0.8
8	Transporti, magazinimi dhe komunikacioni	4.5	3.4	5.6	3.5	3.5	4.2	4.4
9	Ndërmjetesimi financiar	3.0	4.1	4.0	4.5	4.3	4.6	3.7
10	Afarizmi me pasuri të patundshme, dhënia me qira dhe shërbime të afarizmit	12.6	11.8	9.3	9.1	7.9	5.3	5.0
11	Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi social i detyrueshëm (a+b)	17.1	15.0	13.3	12.9	12.5	12.7	13.5
a	<i>Qeveria e Kosoves</i>							
b	<i>Donatorët</i>							
12	Veprimtari të tjera shoqërore sociale, të shërbimeve dhe personale	2.6	2.1	2.6	3.0	2.3	3.3	3.3
13	Gjithsej aktivitetet (1 deri 12)	84.6	84.0	84.5	83.7	82.3	81.0	80.9
14	Tatimet në produkte	15.4	16.0	15.5	16.3	17.7	19.0	19.1
15	FISIM							
16	Subvencionet ne produkte							
	Bruto Produkti Vendor (13+14-15+16)	100	100	100	100	100	100	100

Tabela 3: Bruto produkti vendor sipas aktiviteve ekonomike me çmime konstante 2006-2012

(në 000)

Nr.	Aktivitetet ekonomike	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
1	Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi	394,227	335,282	401,950	479,423	481,698	608,618	582,488
2	Industria nxjerrëse	18,934	18,553	34,340	29,469	36,178	68,641	164,949
3	Industria përpunuese	198,964	288,921	421,069	406,591	321,635	389,079	581,976
4	Furnizimi me energji elektrike, me gaz dhe me ujë	237,752	143,320	142,866	153,492	198,462	205,584	141,222
5	Ndërtimtaria	243,727	282,083	295,461	392,262	283,517	315,142	300,247
6	Tregetia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave dhe i artikujve për përdorim personal dhe shtëpiak	326,245	391,630	510,667	541,665	672,448	392,900	756,926
7	Hotelet dhe restorantet	21,969	3,854	25,426	36,843	61,883	37,588	41,219
8	Transporti, magazinimi dhe komunikacioni	116,274	136,702	139,067	186,438	175,793	195,477	225,145
9	Ndërmjetesimi financiar	96,974	148,233	140,666	196,070	191,141	233,942	180,035
10	Afarizmi me pasuri të patundshme, dhënia me qira dhe shërbime të afarizmit	424,309	469,485	399,868	417,624	386,231	268,923	245,644
11	Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi social i detyrueshëm (a+b)	607,764	574,208	524,477	492,246	508,242	719,986	727,168
a	Qeveria e Kosovës	240,416	239,784	235,291	253,793	325,323	536,737	512,237
b	Donatorët	330,300	334,424	289,187	238,452	182,919	183,250	214,931
12	Vepimtarit të tjera shoqërore sociale, të shërbimeve dhe personale	42,228	93,960	150,839	198,037	138,042	217,034	161,213
13	Gjithsej aktivitetet	2,729,367	2,886,232	3,186,698	3,530,160	3,455,271	3,652,915	4,108,233
14	FISIM	75,447	91,866	117,611	111,055	120,515	136,704	104,634
15	Tatimet në produkte	501,222	643,454	712,948	758,611	882,395	1,049,943	968,846
16	Subvencionet në produkte	(50,049)	(58,379)	(71,289)	(100,719)	(80,677)	(80,159)	(81,445)
Bruto Produkti Vendor (13-14+15+16)		3,105,093	3,379,441	3,710,746	4,076,997	4,136,474	4,485,994	4,891,000

Tabela 4: Bruto produkti vendor me qasjen e shpenzimeve 2004-2012

(në milion Euro)

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
BPV me çmime aktuale	2,911.8	3,002.8	3,120.4	3,460.8	3,940.3	4,007.8	4,291.1	4,769.8	4,916.4
Shpenzimet e konsumit final	3,212.7	3,367.6	3,466.2	3,810.6	4,344.6	4,301.0	4,557.2	5,019.8	5,256.1
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake	2,487.6	2,638.4	2,770.8	3,145.9	3,646.7	3,605.4	3,821.9	4,219.8	4,447.6
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	701.5	705.5	670.6	641.6	674.4	670.5	709.3	769.0	788.3
Qeveria e Kosovës	355.5	329.2	340.8	327.3	372.6	409.7	482.7	545.2	571.2
Donatorët (pagat)	346.0	376.3	329.8	314.3	301.8	260.8	226.6	223.7	217.1
Të punësuar të huaj	247.8	258.4	213.2	196.9	196.9	178.7	157.4	155.5	150.9
Të punësuar vendor	98.2	117.9	116.6	117.4	104.9	82.1	69.2	68.2	66.2
Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH	23.5	23.7	24.8	23.1	23.6	25.0	26.0	31.1	20.2
Formimi i bruto kapitalit	701.2	722.2	798.3	892.5	1,093.9	1,164.1	1,342.0	1,543.3	1,387.0
Formimi i bruto kapitalit fiks	583.6	592.8	657.1	744.3	937.9	1,026.5	1,192.6	1,386.8	1,238.7
Ndryshimet në inventar	117.7	129.4	141.2	148.3	156.0	137.6	149.4	156.5	148.3
Eksporti neto	-1,002.1	-1,087.0	-1,144.1	-1,242.3	-1,498.2	-1,457.2	-1,608.1	-1,793.3	-1,726.7
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	310.0	332.8	441.4	547.1	608.9	657.0	835.1	943.4	922.1
Eksporti i mallrave	63.8	67.8	122.5	177.2	216.6	177.2	305.0	324.9	287.0
Eksporti i shërbimeve	246.2	265.0	319.0	369.9	392.4	479.8	530.1	618.5	635.1
Importi i mallrave dhe shërbimeve	1,312.1	1,419.8	1,585.5	1,789.5	2,107.1	2,114.2	2,443.1	2,736.7	2,648.8
Importi i mallrave (FOB)	1,046.9	1,146.3	1,295.6	1,530.1	1,866.3	1,828.9	2,057.1	2,383.9	2,360.0
Importi i shërbimeve	265.2	273.5	289.9	259.4	240.8	285.3	386.1	352.8	288.8
BPV për kokë banori (Euro)¹	1,829	1,851	1,890	2,062	2,310	2,311	2,436	2,668	2,721

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

311(496.51) "2013": 33 (084.2)

Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteve ekonomike 2006-2012
/ [Publikimin përgatitën Ilir T. Berisha]. Prishtinë : Agjencia e
Statistikave të Kosovës, 2013. - 14 f. : ilustr. ; 28 cm. - (Seria 3 :
Statistikat Ekonomike)

Parathënie / Isa Krasniqi: f. [II]

ISBN 978-9951-22-022-4

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: *Departamentet prodhuese;* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. *Departamentet mbështetëse;* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Në kuadër të Agjencionit vepron edhe; Zyra për regjistrimin e popullsisë ekonomike familjare dhe banesave si dhe **Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj**

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 139 punëtorë, prej tyre, 104 (74,8%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 35 (25,2%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 70,5% me shkollim universitar ndërsa 29,5% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njëjive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Kemi realizuar me sukses në vitin 2011 projektin e Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe banesave, i cili regjistrim nuk është realizuar që nga viti 1981. Rezultatet e fituara nga ky regjistrim do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë. Në vijim e sipër është përgatitja për Regjistrimin e Bujqësisë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 104
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** economic@rks-qov.net
- **Ueb-faqe:** <http://esk.rks-qov.net>

ISBN 978-9951-22-022-4



9 789951 220224